



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 11.02.2019
(Dokument parlamentar)

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR
PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”

- HYRJE

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 28 dhe 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 11.02.2019, mori në shqyrtim projektligjin “ Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ”

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Sadi Vorpsi.

Për të bërë prezantimin e marrëveshjes në komision morën pjesë përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës si dhe të nenit 17 të ligjit nr.43/2016 “ Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë ” dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji synon ratifikimin e protokollit të Traktati i Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nënshkruar më 6.2.2019, në Bruksel, i cili në aspektin politik, është në zbatim të plotë të politikës së NATO-s të “Dyerve të hapura” dhe gjithashtu përbën një

shembull të qartë të parimit politik demokratik se çdo shtet sovran ka të drejtën e pakundërshtueshme për të zgjedhur në mënyrë të lirë aleancat e veta.

Traktati i Atlantikut Verior, si dokumenti kryesor themelues i NATO-s, në nenin 10 të tij parashikon mënyrën e anëtarësimit të vendeve të reja në këtë Aleancë. Ky nen parashikon në mënyrë të qartë se vendimi për anëtarësimin e shteteve të reja merret me unanimitet nga ana e shteteve anëtare.

Vendet anëtare të NATO-s vendosën në takimin e krerëve të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të Aleancës, të mbajtur më 11-12 korrik 2018 që t'i akordojnë Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t'u anëtarësuar në NATO.

Kjo ftesë erdhi në vlerësim të vullnetit të vazhdueshëm politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'u anëtarësuar në NATO, reformave të ndërmarra nga ky vend në rrugën drejtë anëtarësimit, angazhimit të këtij vendi për përballimin e sfidave të sigurisë si dhe angazhimi për të përfunduar marrëveshjen historike lidhur me emrin, ndërmjet Athinës dhe Shkupit.

Nënshkrimi i këtij protokolli, më 6 shkurt 2019 nga të plotfuqishmit e 29 vendeve anëtare në NATO dhe ratifikimi nga parlamentet e tyre, nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga Parlamenti yne, do të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Traktatin e Atlantikut të Veriut, duke e bërë kështu Maqedoninë e Veriut anëtarin e 30-të të NATO-s.

Ky anëtarësim do të ndikojë drejtpërsëdrejti në rritjen e sigurisë në hapësirën euroatlantike dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të reduktojë më tej influencën e fuqive të treta në rajonin tonë dhe do të ndikojë ndjeshëm në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, ndaj nisur nga këto ju ftoj të nderuar kolege ta miratojmë atë.

- DIKSUTIME NË KOMISION

Gjatë dikutimeve në komision, përfaqësuesi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme Z. Skapi në fjalën e tij theksoi rëndësinë e kësaj marrëveshje, e cila do të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Traktatin e Atlantikut të Veriut, duke e bërë kështu Maqedoninë e Veriut anëtarin e 30-të të NATO-s .

Z.Skapi u shpreh se në aspektin institucional Republika e Maqedonisë së Veriut ka bërë një rrugë relativisht të gjatë drejt anëtarësimit në NATO. Kështu, përpjekjet institucionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të arritur anëtarësimin në NATO filluan me anëtarësimin në nismën e partneritetit për paqe (PfP) më 15 nëntor 1995. Republika e Maqedonisë së Veriut është prej vitit 2009 dhe është vlerësuar pozitivisht nga vendet aleate për pjesëmarrjen e saj në misionet ndërkombëtare të paqeruajtjes, duke filluar që prej vitit 2002 me Misionin e ISAF në Afganistan si dhe në vitin 2006 në misionin e BE-së “ALTHEA”, në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Pas relatimit edhe të z.Vorpsi u vlerësua kjo nisëm, e cila i shërben konsolidimit të mëtejshëm të sigurisë në hapësirën e Atlantikut të Veriut.

Në përfunim të diskutimeve, përfaqësuesit e për Evropën dhe Punët e Jashtme sqaruan se Protokolli do të hyjë në fuqi kur secila nga palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut të ketë njoftuar për vendimin e marrë qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për Republikën e Shqipërisë kjo procedurë do të ndiqet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ratifikimit të këtij protokolli. Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të njoftojë të gjitha palët në Traktatin e Atlantikut të Veriut për datën e hyrjes në fuqi të protokollit.

- PËRFUNDIME

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATOR

KRYETARE

Sadi VORPSI

Ermonela VALIKAJ (FELAJ)